



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERJISË

**Bordi**

**VENDIM**

**Nr. 202, Datë 13.09.2018**

**MBI**

**RINOVIMIN E LICENCËS NR. 74 SERIA T08P, TË SHOQËRISË “GEN-I TIRANA” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “d” të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” si dhe në zbatim të nenit 4, pika 1, gërma “e”, nenit 5, pika 1 gërma “e”; neneve 13 dhe 16 të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin dhe Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike” të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.06.2016, si dhe nenit 15 të “Rregullores për Organizimin, Funksonimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 13.09.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për rinovimin e licencës nr. 74 Seria T08P, të shoqërisë “Gen-I Tirana” sh.p.k, në veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “Gen-I Tirana” sh.p.k., është mbajtëse e licencës nr. 74 Seria T08P, për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike dhënë me venimin e Bordit të Komisionerëve të ERE nr. 130, datë 02.12.2008, për një afat 5 – vjeçar.
- Kjo licencë është rinovuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, me nr. 105, datë 01.10.2013, për një afat 5 vjeçar.
- Në prag të përfundimit të afatit kohor të licencës, shoqëria “Gen-I Tirana” sh.p.k., kërkon rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike në bazë të nenit 16, pika 1 (*Jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë, personi mund/duhet të kërkojë në ERE rinovimin e licencës duke paraqitur dokumentat përkatëse*) të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin dhe Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”.
- Bordi i ERE me vendimin nr. 186, datë 20.08.2018, filloi procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “Gen-I Tirana” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Në vijim të sa më sipër, ERE me shkresën nr. 55/55 Prot., datë 23.08.2018, publikoi në median e shkruar njoftimin për fillimin e kësaj procedure dhe me shkresën nr. 523/1 Prot., datë 23.08.2018, i ka kërkuar subjektit “Gen-I Tirana” sh.p.k., të paraqesë në ERE dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me bilancin financiar të vitit 2017, duke qënë se nga analiza e dokumentacionit të aplikimit, rezultoi se nuk ishte paraqitur.
- Subjektit “Gen-I Tirana” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 523/2 Prot., datë 29.08.2018, ka paraqitur në ERE dokumentacionin e munguar sipërcituar.
- Nga analiza që i’u bë dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “Gen – I Tirana” sh.p.k., gjatë fazës finale të shqyritimit në bazë të “*Rregullores për Procedurat e Licensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/të Pjesshëm dhe Rinovimit të Licensave*”, rezulton si më poshtë:
  - Formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1. Plotësuar;
  - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2. Plotësuar;
  - Dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3. Plotësuar;
  - Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjise elektrike, neni 9, pika 4.8. Plotësuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

#### **Vendosi:**

1. Të rinovojë licencën nr. 74 Seria T08P, të shoqërisë “Gen-I Tirana” sh.p.k., në veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike për një afat 5 vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**